

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6908  
E martë, 30 maj 2023  
Çmimi 0.40 €

## Çfarë e pret Erdoganin në mandatin e ri presidencial? | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

POLICIA E KOSOVËS, TRUPAT E MISIONIT PAQERUAJTËS TË NATO-s  
NË KOSOVË DHE KFOR-I KANË SHTUAR PRANINË NË VERI | FAQE 4

# HOVENIERI PËRCJELL MESAZHIN E SHBA-së: JEMI THELLËSISHT TË SHQETËSUAR PËR SITUATËN NË VERI



Grupe të qytetarëve serbë janë mbledhur sërish të hënën para zyrave të komunave në Zvečan, Zubin Potok e Leposaviq për ta penguar hyrjen e kryetarëve shqiptarë. Forca të shtuara të Policisë së Kosovës dhe të misionit të NATO-s, KFOR, kanë qenë të

pozicionuara në të tria komunat e banuara me shumicë serbe. Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se bashkësia ndërkombëtare është "thellësisht e shqetësuar" për situatën në veri. Pas takimit që zhvilloi me presidenten e

Kosovës, Vjosa Osmani dhe me kryetarin e Zubin Potokut dhe Zveçanit, Hovenieri tha për mediet se me të parën e vendit kanë shprehur "shqetësimin për mundësinë e dhunës dhe nevojën për ta shtensionuar situatën"

## AKTUALE



SPANJA SHKON NË ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE | F. 2

MINISTRI VITIA DHE AMBASADORI I BE-SË DISKUTUAN PËR INVESTIMET NË SEKTORIN E SHËNDËTËSISË | F. 7


JAVËN QË SHKOI POLICIA RAJONALE E FERIZAJT SHQIPTOI 1 245 GJOBA | F. 6

## EKONOMI



MITROVICA E VERIUT DHE LEPOSAVIQI KËRKOJNË TË PAGUAJNË PËR RRYMËN E SHPENZUAR | F. 8

## SPORT



DY NDESHJET E DYSHUARA PËR KURDISJE JANË PROCEDUAR PËR HETIME NË PROKURORITË PËRKATËSE | F. 10

NGREHET  
AKTAKUZË  
KUNDËR DONIKA  
GËRVALLËS,  
KJO THOTË SE  
FUSHATAT E TILLA  
NUK PINË UJË | FAQE 7



SIMBOLET  
KOMUNISTE NXISIN  
DEBAT NË SHQIPËRI | FAQE 2



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Çfarë e pret Erdoganin në mandatin e ri presidencial?

STAMBOLL, 29 MAJ - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka mandat për të qeverisur deri në vitin 2028, pasi siguroi edhe pesë vjet të tjera si udhëheqës i vendit që luan një rol kyç në NATO. Tani ai duhet të përballet me inflacionin në rritje dhe ta rindërtojë një pjesë të vendit të shkatërruar nga tërmeti që la të vdekur më shumë se 50 000 njerëz.

Erdogani i siguroi më shumë se 52 për qind të votave në balotazhin presidencial të 28 majit, dy javë pasi nuk arriti t'i fitonte zgjedhjet në raundin e parë. Erdogan falënderoi votuesit që ia besuan sërish presidencën e vendit në dy fjalimet që i mbajti në Stamboll dhe Ankara. "Fituesi i vetëm sot është Turqia", tha Erdogan jashtë pallatit presidencial në Ankara, duke premtuar se do të punojë shumë gjatë shekullit të dytë të Turqisë, që ai e quajti "shekulli turk". Turqia shënon njëqindvjetorin këtë vit. Më pas, mbështetësit e Erdoganit dolën në rrugë për të festuar, duke valëvitur flamujt e Turqisë ose të partisë në pushtet dhe duke brohoritur emrin e Erdoganit. Udhëheqësit e shteteve të tjera i

dërguan urimet e tyre, duke theksuar rolin e Turqisë dhe të Erdoganit në politikën globale. Politikanët perëndimorë thanë se janë të gatshëm të vazhdojnë të punojnë me Erdoganin pavarësisht prej marrëdhënieve ndonjëherë të tensionuara në vitet e fundit.

Turqia ka në duar shpresat e Suedisë për t'u anëtarësuar në NATO, gjë që anëtarët e tjerë të aleancës e kanë kërkuar për ta forcuar partneritetin kundër Rusisë. Turqia, gjithashtu, ka rol kyç në vazhdimin e marrëveshjes për t'i lejuar transportet e grurit nga Ukraina dhe për ta shmangur një krizë globale ushqimore.

Në fjalimin e tij pas fitores, Erdogani tha se rindërtimi i qyteteve të shkatërruara nga tërmeti do të jetë prioritet i tij. Ai, gjithashtu, tha se një milion refugjatë sirianë do të kthehen në "zonat e sigurta" të kontrolluara nga Turqia në Siri si pjesë e një projekti zhvendosjeje që po planifikohet bashkë me Katarin. Në këto zgjedhje Erdogan pati mbështetjen e votuesve konservatorë. Gjatë fjalimit të tij, Erdogani tha se pjesëtarët e komunitetit LGBTI+ nuk mund ta



"infiltronjë" partinë e tij ose aleatët e saj.

Erdogani e transformoi presidencën nga një rol kryesisht ceremonial në pozitë të fuqishme përmes një referendumi të fituar me rezultat të ngushtë më 2017, që hoqi sistemin parlamentar të qeverisjes së Turqisë. Ai ishte presidenti i parë i zgjedhur me

votë të drejtpërdrejtë në vitin 2014 dhe i fitoi edhe zgjedhjet e vitit 2018 që sollën presidencën ekzekutive.

Erdogani po kryen tani mandatin e tij të dytë si president nën presidencën ekzekutive. Ai mund të kandidojë sërish për një mandat tjetër nëse Parlamenti - ku partia e tij dhe aleatët e saj e kanë

shumicën - shpall zgjedhje të parakohshme.

Numri i mandateve ishte një pikë mosmarrëveshjeje përpara zgjedhjeve, kur kritikët argumentuan se Erdogan nuk duhej të rikandidonte pasi e kishte mbajtur detyrën e presidentit edhe përpara ndryshimit të sistemit. (AP)

## Spanja shkon në zgjedhje të parakohshme parlamentare



Madrid, 29 maj - Kryeministri spanjoll Pedro Sanchez ka njoftuar të hënën se Spanja do të shkojë në zgjedhje të përgjithshme të parakohshme më 23 korrik. Ky vendim erdhi pasi partia që Sanchez drejton, Partia Socialiste (PSOE), pësoi humbje të konsiderueshme në zgjedhjet lokale dhe rajonale. Më parë Sanchez kishte këmbëngulur se do ta përfundonte mandatin e tij të plotë katërvjeçar së bashku me partnerin e koalicionit të qeverisë së majtë, Partinë "Së Bashku Mundemi", me pritshmërinë e mbajtjes së

zgjedhjeve në dhjetor. Megjithatë, rezultati i votimeve të fundit lokale dhe rajonale i ndryshoi me shpejtësi planet e tij.

"Unë e kam marrë këtë vendim bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të djeshme", ka deklaruar Sanchez të hënën nga pallati presidencial Moncloa.

Sfidat me të cilat përballet Sanchez dhe partia e tij PSOE përkohë me marrjen e ardhshme të presidencës së radhës të Bashkimit Evropian nga Spanja më 1 korrik.

Sanchez përmendi se ai kishte

diskutuar për këtë çështje me Mbretin Felipe VI dhe synonte të thërriste një mbledhje të posaçme të kabinetit të hënën për ta shpërndarë parlamentin. Data e vendosur për zgjedhjet e parakohshme vjen në mes të periudhës së pushimeve verore të Spanjës, me shumë njerëz që ka të ngjarë të jenë larg zonave të tyre të votimit.

Zgjedhjet e fundit lokale dhe rajonale në Spanjë sollën një ndryshim të rëndësishëm për vendin, duke vendosur Partinë Popullore (PP) konservatore të opozitës si forcën kryesore politike të vendit.

## BE-ja bëhet gati për temperatura të larta, dyfishon kapacitetet për luftimin e zjarreve

BRUKSEL, 29 MAJ - Bashkimi Evropian ka dyfishuar numrin e pajisjeve në dispozicion për luftimin e zjarreve në pyje, tha komisionari i BE-së për menaxhimin e krizave, Janez Lenarcic. Gjithsej 28 pajisjet do të mund të përdoren për kriza në shtetet anëtare të bllokut evropian si dhe në vendet fqinje.

Dhjetë aeroplanët e tipit Canadair, 14 avionë të lehtë dhe katër helikopterë do të jenë gati për atë që pritet të jetë një "verë tejet e ngarkuar", tha Lenarcic në një intervistë me European Newsroom. "Ky vit ka nisur tashmë me më shumë thatësi se

zakonisht", tha ai, duke vënë në dukje thatësinë e raportuar më parë në Portugal, Spanjë, Francë jugore dhe Itali veriore. Ndërkohë, së fundi, në disa prej këtyre vendeve ka pasur përmbetje pasi uji i grumbulluar nga reshjet e shiut nuk absorbohej lehtësisht nga toka tejet e thatë.

Kjo thatësi e hershme e pazakontë, së bashku me temperaturat në rritje që po regjistrohen tani në Evropë, janë, "natyrisht, një nxitës kryesor i zjarreve në pyje", tha Lenarcic.

Pasi viti 2022 solli verën më të nxehtë të regjistruar në Evropë,

shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, në shtator njoftoi për planin për dyfishim të flotës ajrore të zjarrfikësve.

Flota është e shpërndarë në mënyrë strategjike në të gjithë BE-në në mënyrë që të mund të përgjigjet shpejt kur flakët shpërthejnë në periudhën kritike nga qershori deri në tetor. Avionët janë të stacionuar në dhjetë shtete anëtare: Kroaci, Qipro, Çeki, Francë, Gjermani, Greqi, Itali, Portugali, Spanjë dhe Suedi.

Ky mekanizëm i BE-së u krijua në vitin 2001. Në dy dekadat e para ai aktivizohej mesatarisht 20 herë në vit.



# Simbolet komuniste nxisin debat në Shqipëri



**TIRANË, 29 MAJ** - Restaurimi i mozaikut "Shqipëria", që gjendet në qendër të Tiranës, ka rikthyer debatin lidhur me largimin e simboleve të periudhës komuniste nga veprat artistike. Punimet në mozaik përfunduan pas dy vjetësh dhe kjo vepër u inaugurua më 17 maj, duke shënuar nisjen e disa aktiviteteve për Javën e Evropës në Shqipëri. Mozaiku u restaurua pas dëmtimeve të pësuar, duke bërë që copëza të tij të binin, duke rrezikuar edhe kalimtarët. Por, punimet nuk kanë prekur në tërësi veprën. Kjo për shkak se më 1993, përmes një vendimi të qeverisë së atëhershme të Aleksandër Meksit dhe dekretit të presidentit Sali Berisha, nga kjo vepër ishte hequr ylli i madh që gjendej pas personazheve, ylli me flamur të kuq si dhe një libër që mbante në duar një prej personazheve, e që ishte një prej veprave të diktatorit shqiptar Enver Hoxha. Restaurimi u bë me një fond prej 1 milion eurosh, që i ndau Bashkimi Evropian, dhe vepra mbeti ashtu siç kishte qenë më 1993, me disa simbole komuniste. Debatu u nxit pasi studiuesi Auron Tale pyeti përmes rrjeteve sociale nëse "duhet retushuar historia?". "A duhet që post-komunizmi të veprojë ashtu si komunizmi, të mësojë historinë e deformuar", shkroi ai në "Facebook". Megjithatë, ky debat për ministren e Kulturës në Shqipëri, Elva Margariti, është "një debat

shterpë". Margariti thotë për "Radion Evropa e Lirë" se çdo epokë ka pasur artin e vet, duke shtuar se për rishikimin e artit apo historisë kërkohet një debat më i gjerë. "Vetë fjala restaurim do të thotë rikuperim i gjendjes aktuale në të cilën gjendet vepra. Debatu për mua është shterpë në këtë moment. Ne nuk kemi fshirë asgjë, pasi simbolet e komunizmit janë hequr që në vitin '93, madje në atë kohë është diskutuar edhe heqja e mozaikut. Ne u jemi përmbajtur konventave ndërkombëtare dhe i kemi dhënë sigurinë që duhej këtij mozaiku, që po dëmtohej e rrezikonte të binte. Restaurimi është bërë në bashkëpunim autorët e veprës", thotë ministrja Elva Margariti. Pavarësisht se disa simbole të komunizmit ishin hequr nga mozaiku "Shqipëria" 30 vjet më parë, pas restaurimit të kësaj vepre është nxitur debati nëse veprat e artit të periudhës komuniste në Shqipëri duhen mbajtur apo hequr. Por, ministrja Margariti thotë se gjysma e veprave në Galerinë Kombëtare të Arteve në Shqipëri janë nga regjimi komunist. Megjithatë, ajo thotë se ato nuk mund të cilësohen si propagandë, por tregojnë se si në atë periudhë është bërë propagandë përmes artit, por ato, sipas saj, "kanë vlerat e tyre artistike". "Shqipëria" është një mozaik që ka shumë vlera, është mozaiku më i madh i realizuar

ndonjëherë në fasadën e një ndërtese. Gjithashtu, është pjesë e ansamblit të sheshit "Skënderbej", të sheshit qendror të Tiranës, kështu që diskutimi për ta hequr fare, është një debat i cekët. Duhet t'i studiojmë dhe të flasim për këto vepra, por duhet ndarë mjeshhtëria, vepra e artit nga politika, ideologjia e asaj kohe", thekson ministrja Margariti. Edhe për studiuesin Ergys Mërtiri debati për këtë çështje është i ndërlikuar. "Ne nuk mund ta kemi këtë mozaik me flamurin me yll, dhe sigurisht që duhej hequr ylli ose nuk duhej që restaurimi ta risillte, sepse është hequr 30 vjet më parë. Për mua mozaiku përcjellë shtrembërim të historisë, përcjellë më shumë propagandë sesa art. Gjithsesi nëse do të ishte në një muze, nuk shoh ndonjë problem, por në një vend publik, është një tjetër diskutim. Kur shohin këto simbole qytetarët që kalojnë aty, të jeni të sigurt që i vret disa njerëz që kanë vuajtur në komunizëm apo të tjerë që e urrejnë atë kohë për atë që kanë dëgjuar", thotë Mërtiri për "Radio Evropa e Lirë".

## Qytetarët për dhe kundër mozaikut "Shqipëria"

Për mozaikun "Shqipëria", që gjendet në qendër të Tiranës, edhe qytetarët kanë qëndrime të ndryshme sa i përket kësaj vepre

dhe simbolikës që bart. "Mozaiku është historia e popullit tonë që ka luftuar për liri, që në kohën e lashtë me shpata e mburoja, e deri te lufta nacionalçlirimtare. Pra, tregon të gjitha luftërat, që duhen vlerësuar dhe nuk duhen harruar. Sigurisht kujton edhe komunizmin, por kishte të mirat e të këqijat e veta, ndaj duhet ta mbajmë mozaikun, madje ashtu siç ishte, se ylli thjesht ka treguar pesë kontinentet, nuk është ndonjë gjë e keqe", thotë Kostandin Pali. Por, ndryshe mendon Anest Qelesi. Sipas tij, kjo vepër arti prek ata persona që kanë vuajtur nga regjimi komunist në Shqipëri. "Ai sistem i ka bërë dëm një pjese të rëndësishme të popullit tonë dhe mozaiku na kujton veç gjëmat që u janë bërë mijëra njerëzve dhe ne duhet të kemi respekt për këtë shtresë. Nuk kanë as ndonjë pension të mirë, as ndonjë trajtim të veçantë, pse t'i lëndojmë? Këto simbole do t'i ngacmojnë, do t'u hapim plagë këtyre personave që ne ende nuk i kemi integruar. Edhe të mos ishte fare nuk ka asgjë, mirë do të ishte. Ose të rishikohen, të ridimensionohen, që të mos lëndojnë të persekutuuarit", thotë ai. Ky mozaik ishte përfunduar më 28 nëntor të vitit 1981 dhe ishte krijuar nga pesë autorë. Një prej tyre është Agim Nebiu. Ai ka deklaruar për mediet se do të ishte e turpshme që kjo vepër të lihej të shkatërrohej. Ndërsa për debatin që është nxitur, ai e ka cilësuar si të

politizuar, teksa e ka përshkruar mozaikun si "simbol që duhet të mbetet në historinë e Shqipërisë".

## "Yjet... që nuk bien"

Megjithëse më 1993 ishin hequr dy yje të mëdhenj nga mozaiku, në të ka ende yje që vlerësohen si simbole të komunizmit. Disa prej tyre gjenden në kapelat e partizanëve, që janë pjesë e mozaikut të vendosur në fasadën e Muzeut Kombëtar të Shqipërisë. Yjet e tjerë gjenden në xhubletën e gruas që personifikon "Nënë Shqipëri". Edhe pse xhubleta është veshja më e vjetër shqiptare, që daton 4 000 vjet më parë, në fundin e xhubletës së paraqitur në mozaik nuk është stolisur me simbolikat që kjo veshje ka që nga lashtësia, siç janë: hëna, dielli, apo edhe ylli me tetë cepa. Në të është ylli me pesë cepa, që është simbol i komunizmit. Për vite të tëra në Shqipëri ka një debat të hapur lidhur me rishikimin e historisë dhe rishikimin e veprave artistike. Vitin e kaluar partitë opozitare dorëzuan në Kuvend një nismë ligjore, e cila kërkon që filmat, këngët, fotografitë, madje edhe lapidarët që kujtojnë të kaluarën komuniste të Shqipërisë, të ndalohen me ligj. Kuvendi i Shqipërisë, po ashtu, ka miratuar edhe një ligj për hapjen e dosjeve të periudhës komuniste, që synon pastrimin e skenës politike nga persona që mund të kenë pasur lidhje me sigurimin e shtetit gjatë regjimit komunist.



POLICIA E KOSOVËS, TRUPAT E MISIONIT PAQERUAJTËS TË NATO-S  
NË KOSOVË DHE KFOR-I KANË SHTUAR PRANINË NË VERI

# Hovenieri përcjell mesazhin e ShBA-së: Jemi thellësisht të shqetësuar për situatën në veri

Grupe të qytetarëve serbë janë mbledhur sërish të hënën para zyrave të komunave në Zveçan, Zubin Potok e Leposaviq për ta penguar hyrjen e kryetarëve shqiptarë. Forca të shtuara të Policisë së Kosovës dhe të misionit të NATO-s, KFOR, kanë qenë të pozicionuara në të tria komunat e banuara me shumicë serbe. Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se bashkësia ndërkombëtare është “thellësisht e shqetësuar” për situatën në veri. Pas takimit që zhvilloi me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani dhe me kryetarin e Zubin Potokut dhe Zveçanit, Hovenieri tha për mediet se me të parën e vendit kanë shprehur “shqetësimin për mundësinë e dhunës dhe nevojën për ta shtensionuar situatën”

Quint-it së bashku e kanë thënë se është e rëndësishme të shmangen rrethanat kur zyrtarët publikë hyjnë me dhunë në ndërtesat publike. Ky vazhdon të jetë qëndrimi ynë, prandaj biseda jonë me kryetarët ishte se si ata mund t'i pëmbushin detyrat e tyre për t'iu shërbyer të gjithë qytetarëve, siç pritet nga ta dhe siç ne duam që ata të veprojnë, por në një mënyrë që tregon se ata janë të përkushtuar për të qenë përgjegjës për të gjithë qytetarët, që për ne tani nënkupton moshyrjen në ndërtesat publike përmes përdorimit të forcës”, ka

deklaruar Hovenieri. Në takimin me ambasadorin amerikan morën pjesë vetëm kryetari i Zubin Potokut, Izmir Zeqiri, dhe ai i Zveçanit, Ilir Peci, të cilët vijnë nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës. Ndërkaq kryetari i Mitrovicë së Veriut, Erden Atiq, dhe ai i Leposaviqit, Lulzim Hetemi, nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, nuk morën pjesë. Hovenieri ka bërë me dije se të dy kishin pranuar ftesën për takim. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se i kupton shqetësimet e partnerëve ndërkombëtarë, por “çdo opsion tjetër do të ishte mospërbushje e obligimeve kushtetuese”. Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës është shprehur tejet i shqetësuar me situatën e krijuar për mediet dhe gazetarët të cilët po raportojnë nga këto komuna, duke kërkuar nga gazetarët të kenë kujdes të shtuar gjatë raportimit.

**KFOR-i, thirrje Prishtinës dhe Beogradit: Angazhohuni në dialog dhe ulini tensionet**

Mëngjesin e së hënës misioni i KFOR-it, i udhëhequr nga NATO, ka shtuar praninë e tij në katër komunat e veriut të Kosovës pas zhvillimeve të fundit. “Qëllimi i pranisë së KFOR-it është të sigurojë një mjedis të sigurt dhe liri të lëvizjes për të gjitha komunitetet në Kosovë në përputhje me mandatin e tij nga

edhe me krerin e Zubin Potokut Tomas Szunyog. “Ne jemi dhe të Zveçanit. I pranishëm në takim ishte edhe shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë, qëveria amerikane dhe qeveritë e

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 MAJ - Të hënën sërish grupe të serbëve lokalë janë mbledhur para ndërtesave komunale në veri për t'i kundërshtuar kryetarët e rinj shqiptarë. Përveç Policisë së Kosovës, e cila ka qenë e pranishme para ndërtesave komunale, në veri ka pasur edhe shtim të pranisë së pjesëtarëve të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR.

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se bashkësia ndërkombëtare është “thellësisht e shqetësuar” për situatën në veri të Kosovës. Pas takimit që zhvilloi me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, ai tha për mediet në Prishtinë se me të parën e vendit kanë shprehur “shqetësimin për mundësinë e dhunës dhe nevojën për ta shtensionuar situatën”.

Hovenieri të hënën është takuar





Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të vitit 1999. Ne u bëjmë thirrje të gjitha palëve të përbahen nga veprimet që mund të nxisin tensione ose të shkaktojnë përshtetshmëri, ka njoftuar KFOR-i.

Po në njoftim theksohet se në përputhje me mandatin e tij, KFOR-i është i gatshëm t'i ndërmarë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar një mjedis të sigurt në mënyrë neutrale dhe të paanshme. Komandanti i KFOR-it mbetet në kontakt të ngushtë me bashkëbiseduesit e tij kryesorë, duke përfshirë përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave të Sigurisë në Kosovë, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Serbisë, si dhe me

## KFOR-i i shpërndan protestuesit në Zveçan

Misioni paqeruajtës i NATO-s, KFOR, ndërhyri për shpërndarjen e protestuesve në Zveçan. Paraprakisht i paralajmëroi protestuesit të shpërndahen, por ata nuk u bindën. "Ju po shkaktoni trazira. Po e rrezikoni veten dhe komunitetin tuaj. Largohuni nga zona dhe shkoni në shtëpi, në të kundërtën KFOR-i do të detyrohet të ndërhyjë", ishte audio-paralajmërimi i KFOR-it. Gaz lotsjellës, flakë dhe shtëllunga tymi kanë përfshirë zonën, ndërkohë që dëgjoreshin edhe sirenat.

një kolonel amerikan të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, Igor Simiq dhe Dragisha Milloviq nga Lista Serbe kërkuar që njësitë speciale të Policisë së Kosovës të zëvendësohen me trupat e KFOR-it në mënyrë që këta të fundit t'i ruajnë ndërtesat komunale.

protestuesit serbë të tërhiqen. "Kërkesat tona janë që shtetë - siç e quajmë veten - të paligjshëm, të shkojnë në shtëpitë e tyre dhe t'i udhëheqin të afërmit e tyre. Dhe, të gjitha njësitë speciale në ndërtesën e komunës, përreth komunës, të tërhiqen në jug, sepse ky nuk është stacion policie, është bashki e qytetit", tha Rakiq në Zveçan.

**Instituti OCTOPUS: Njerëz të maskuar në protestat në veri, mund të jenë të gatshëm për sulme terroriste**

Drejtori i Institutit OCTOPUS, Agim Musliu, ka bërë me dije se në mesin e protestuesve janë disa të maskuar, të cilët mund të jenë të gatshëm për akte terroriste. "Struktura ilegale dhe kriminale, njerëz të maskuar në protestat në veri. Instituti OCTOPUS shpreh shqetësimin se në mesin e protestuesve mund të ketë edhe njerëz që janë të gatshëm për akte terroriste! Bashkëpunëtorët e Institutit OCTOPUS kanë thënë se protestuesit në terren janë

"Mund të them se ka qenë vërtet një bisedë korrekte, se koloneli e kupton situatën në të cilën jemi të gjithë. Kërkesa jonë ka qenë që njësitë speciale të tërhiqen nga ndërtesa e komunës, të largohen nga ndërtesa e komunës dhe sigurinë ta marrë KFOR-i. Ai [koloneli] po flet tani me komandantin e përgjithshëm të KFOR-it për kërkesën tonë", tha Milloviq para të tubuarve, duke shtuar se: "Presim përgjigje se çfarë do të na thotë koloneli amerikan i KFOR-it", shtoi ai. Më herët gjatë ditës kreu i Listës Serbe, Goran Rakiq, tha se ish-in dy kërkesa që ua kishte përcjellë përfaqësuesve të KFOR-it dhe ambasadorëve të huaj në Prishtinë në mënyrë që



misionin e udhëhequr nga BE-ja për Sundimin e Ligjit (EULEX) dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit ndërkombëtar. KFOR-i i kërkon Beogradit dhe Prishtinës të angazhohen në dialogun e udhëhequr nga BE-ja për t'i ulur tensionet si e vetmja rrugë drejt paqes dhe normalizimit", ka bërë me dije KFOR-i në një njoftim për medie.

**Lista Serbe, kërkesë të re për tërheqjen e protestuesve**

Pasditën e 29 majit përfaqësuesit e Listës Serbe kanë paraqitur një kërkesë të re në mënyrë që protestuesit serbë të tërhiqen nga ndërtesat e komunave në veri ku edhe janë tubuar. Pas bisedës me

udhëheqë me një apo dy për qind të votave", ka pohuar Von Cramon. Ajo i bëri thirrje Qeverisë së Kosovës ta pyesë veten "nëse kjo është qeverisje e mirë", teksa shtoi se duhet të punohet për ndërtimin e besimit me komunitetin serb në veri të Kosovës dhe që ata të mos portretizohen si "kriminelë" dhe "kukulla të Beogradit".

**Kastrati: Pa KFOR-in vështirë të kontrollohet veriu**

Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kadri Kastrati, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Qeveria e Kosovës do ta ketë të pamundur ta mbajë nën kontroll situatën në pjesën veriore të vendit, duke e mbajtur policinë atje. Sipas tij, qeveria duhet ta nisë menjëherë bashkëpunimin me përfaqësuesit ndërkombëtarë në mënyrë që të krijohet një strategji e qartë për shtensionimin e situatës dhe vendosjen e rendit dhe ligjit në veri.

Partnerët kryesorë për Qeverinë e Kosovës, sipas Kastratit, janë përfaqësuesit amerikanë dhe misioni paqeruajtës i NATO-s, KFOR. "Duhet të ulen dhe ta studiojnë këtë situatë me KFOR-in, sepse i vetmi institucion që mund ta mbajë situatën të qëndrueshme në atë pjesë është KFOR-i", tha Kastrati.



**Von Cramon: Qeveria e Kosovës po rrezikon shumë me manovrat në veri**

Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, u shpreh e shqetësuar për situatën në veri të Kosovës në një konferencë për medie në Prishtinë. Ajo tha se Qeveria e Kosovës "duket se po rrezikon shumë me këto manovra në veri". "Natyrisht, kryetarët e zgjedhur janë zgjedhur në mënyrë ligjore. Por, kjo nuk do të thotë se ata kanë legjitimitetin për të hyrë në këto objekte dhe të kenë qasje me forcë. Askush nuk mund të

Sa i takon shtimit të pranisë së KFOR-it në afërsi të objekteve komunale në Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, Kastrati ka pohuar se ky mision është në mbështetje të Policisë së Kosovës. "KFOR-i nuk e thotë hapas, por është në mbështetje të Policisë së Kosovës për ta ruajtur rendin dhe qetësinë, në mënyrë që ajo pjesë të mos bllokohet prapë, të mos vendosen barrkada dhe të mos ndodhë më e keqja, sepse atje ka serbë të armatosur, këtë e dimë të gjithë", ka theksuar Kastrati. Ai shtoi se destabilizimi i kësaj pjese të Kosovës është qëllim i Serbisë. "Serbia është duke dashur ta ndajë veriu e Kosovës. Këtë synim ka. Pra, synimi i saj është të mos i lejojë institucionet e Kosovës në atë pjesë të funksionojnë. Kjo po dihet", tha ai.

Duke i komentuar veprimet e Policisë së Kosovës për të asistuar për futjen në objekte komunale të kryetarëve të rinj, gjenerali Kastrati tha se policia është treguar profesionale dhe se ka zbatuar detyrat e dhëna nga ekzekutivi.



## Fillon rregullimi i rrugës "Iljaz Kurteshi" në fshatin Lubinjë e Poshtme të Prizrenit

PRIZREN, 29 MAJ - Ka filluar rregullimi dhe rehabilitimi i rrugës "Iljaz Kurteshi" në fshatin Lubinjë e Poshtme, që do të jetë shumë funksionale dhe estetike për banorët. Në kuadër të këtij projekti do të

rregullohet rruga në qendër të fshatit dhe sheshi, që janë punë të një rëndësie të veçantë.

Po në këtë projekt përfshihet rruga për këmbësorë në fshatin Mushnikovë, me vlerë

131.418.25 euro, në të cilin Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal participon me 18.000.00 euro, dhe në fshatin Pllanjan MAPL-ja investon komplet 25.320.44 euro për ndërtimin e infrastrukturës.



## Komuna e Skenderajt nënshkruan kontratat me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile

SKENDERAJ, 29 MAJ - Në një ceremoni të organizuar të hënën janë nënshkruar kontratat me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në kuadër të thirrjes së Drejtorisë së Administratës, respektivisht Njësia për të Drejtat e Njeriut-Zyra për Barazi Gjinore.

Të pranishëm në këtë ceremoni kanë qenë kryetari i komunës

Fadil Nura, drejtori Hamit Geci dhe zyrtarja Qefsere Dautaj, të cilët i kanë përgëzuar përfituesit e subvencioneve publike, duke ofruar gjithë bashkëpunimin në funksion të realizimit të aktiviteteve të projekteve. Këto subvencione për shtatë organizata joqeveritare po ndahen për herë të parë nga Njësia për të Drejtat e Njeriut-Zyra për Barazi Gjinore.



## Shërbimi i Laboratorit në Spitalin e Pejës për katër muaj ka kryer 465 mijë parametra laboratorike

PEJË, 29 MAJ - Shërbimi i Laboratorit në kuadër të Spitalit të Përgjithshëm të Pejës operon në kushte moderne, me aparaturë dhe staf profesional. Bazuar në raportet e punës së Spitalit të Pejës, ky është një nga shërbimet më të ngarkuara me punë, duke u shërbyer mijëra pacientëve me analiza të ndryshme laboratorike, jo vetëm pacientëve të spitalizuar në reparte të ndryshme, por

edhe rasteve ambulatore. Vetëm gjatë katër muajve të parë të vitit 2023 janë kryer mbi 465 mijë parametra laboratorike për 29 mijë 846 pacientë. Ndërkaq, gjatë vitit 2022 ishin ofruar mbi 1.5 milion parametra laboratorike për 88 mijë e 305 pacientë. Aktualisht në këtë shërbim janë të punësuar tre specialistë të biokimisë mjekësore dhe 18 laborantë mjekësorë.



## Javën që shkoi policia rajonale e Ferizajt shqiptoi 1 245 gjoba

FERIZAJ, 29 MAJ - Policia Rajonale e Ferizajt ka ndërmarrë një sërë aktivitete për identifikimin e kundërvajtësve të ndryshëm në komunikacion me qëllim të parandalimit të aksidenteve. Në kuadër të këtyre aktiviteteve policia rajonale e Ferizajt gjatë

javës që shkoi ka shqiptuar 1 245 gjoba kundërvajtëse, ndërsa ka hequr edhe 18 patentëshoferë për drejtuesit që kanë shkaktuar kundërvajtje më të rënda në komunikacion. Ndërsa janë raportuar 28 aksidente, prej tyre: aksidente me lëndime 11, persona të

lënduar 18, aksidente me dëme materiale 17.

Policia rajonale e Ferizajt do t'i vazhdojë aktivitetet me synim parandalimin e aksidenteve në komunikacionin rrugor dhe u bën thirrje shoferëve të bëjnë kujdes në komunikacionin rrugor.

## Në Suhadoll dhe në "Lagjen e Doktorëve" zgjedhen Këshilli dhe kryetari i fshatit

MITROVICË, 29 MAJ - Në Suhadoll dhe në "Lagjen e Doktorëve" është mbajtur tubimi me qytetarë për zgjedhjen e kryetarit dhe

anëtarëve të këshillave lokale të fshatrave. Kryetar i këshillit u zgjodh Muhedin Ibishi, ndërsa këshilli i lagjes do të ketë në përbërje

gjithsej nëntë anëtarë. Ky proces i përzgjedhjes është realizuar përmes pjesëmarrjes së nënkryetarit të komunës

Arian Tahiri dhe anëtarëve të komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, Xhyljeta Morina Imeri, Majlinda Kurti dhe Valbona Sadiku.



## Ministri Vitia dhe ambasadori i BE-së diskutuan për investimet në sektorin e shëndetësisë

PRISHTINË, 29 MAJ - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog. Gjatë këtij takimi ministri Vitia e ka falënderuar ambasadorin për kontributin e BE-së për shtetin e Kosovës si dhe kanë diskutuar për projekte të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e

shërbimeve shëndetësore në sektorin publik.

Ministri Vitia theksoi rëndësinë e Zyrës së BE-së në Kosovë si një portë e rëndësishme e përfaqësimit të të gjitha institucioneve të Bashkimit Evropian.

Temë kryesore e diskutimit ishin reformat në sistemin e shëndetësisë, duke përfshirë projektligjet, trajnimet e stafit

shëndetësor, investimet dhe financimet shtesë që do të kontribuojnë për integritetin e institucioneve të shëndetësisë.

Ambasadori Tomas Szunyog shprehi gatishmërinë për ndihmën nga fondet e BE-së në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët në institucionet publike.



## Ngrehet aktakuzë kundër Donika Gërvallës, kjo thotë se fushatat e tilla nuk pinë ujë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 MAJ - Prokuroria ka ngritur aktakuzë ndaj ministres së Punëve të Jashtme, Donika Gërvallës, për veprën penale "Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare". Gërvalla ka reaguar në "Facebook". Ajo ka thënë se kjo çështje është sqaruar përfundimisht që para dy vjetësh. Sipas saj, tani është aktualizuar nga prokurorë të caktuar, gjatë përpjekjeve të përsëritura për të hedhur baltë dhe inkriminuar përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës. "Prokuroria paska zgjedhur ditën e sotme që të publikojë faktin që në janar, pra para katër muajsh, ka ngritur aktakuzë ndaj meje për 'mosdeklarim të pasurisë'. Çfarë rastësie! Në fakt, kjo çështje është sqaruar përfundimisht që para dy vjetësh, pra në vitin 2021. Tani është aktualizuar nga prokurorë të caktuar, gjatë përpjekjeve të përsëritura për të hedhur baltë dhe inkriminuar përfaqësuesit e institucioneve të Republikës dhe për t'i shërbyer kështu fushatave politike e jo vënies së drejtësisë. Shpresoj që gjykata, e cila duhet të merret me këtë rast, të gjykojë bazuar mbi



faktet objektive e jo interesat e prekura individuale të atyre, të cilët dëshirojnë me shantazhe dhe kërcënime të vijnë në krye të institucioneve të drejtësisë. Qytetari i Republikës së Kosovës na njeh të gjithëve. Edhe neve, edhe ata. Na njeh kaq mirë, sa fushatat e tilla nuk pinë ujë", ka

shkruar Gërvalla.

Ajo ka thënë se të gjithë e kemi ditur që ata të cilët humbën jo vetëm zgjedhjet, por edhe mundësinë për të zhvatur edhe më tej shtetin dhe parane publike, nuk do të zgjedhin mjete në betejën e tyre për ta ndaluar sundimin e ligjit dhe

luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. "Madje në çdo ditë të punës sime kam qenë e ndërgjegjshme që duhet të jemi të përgatitur për rreziqe edhe shumë më të mëdha sesa fushatat denigruese. Prandaj ballëhapur dhe me duar të pastra vazhdojmë punën për

përfaqësimin dinjitoz të vendit, rritjen e mirëqenies dhe sigurisë së qytetarëve tanë, mbrojtjen e sovranitetit të Republikës, reformimin e institucioneve dhe vënien në vend të ligjshmërisë së shkelur në mënyrën më brutale për kaq vite me radhë", ka thënë ministrja Gërvalla.

## Keqpërdori pozitën zyrtare, arrestohet ish-zyrtari i gjendjes civile në komunën e Gjakovës

GJAKOVË, 29 MAJ - Njësi Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Gjakovë ka pranuar informatën se një person i dyshuar, ish-zyrtar i gjendjes civile në komunën e Gjakovës, dyshohet se ka regjistruar një person në sistemin e ARC-së në mënyrë të kundërligjshme.

Sipas policisë, hetuesit, në bashkëpunim me Prokurorinë e Gjakovës, kanë kryer veprime hetimore/operative dhe kanë arritur të sigurojnë dëshmi se i

dyshuari me iniciale D. N. kundërligjshëm e ka futur në sistem të gjendjes civile, në mënyrë të kundërligjshme, shtetasin e Republikës së Shqipërisë, duke konsumuar kështu veprën penale "keqpërdorimi i pozitës apo autoritet zyrtar". "Deri te dyshimet bazike është ardhur pasi për shtetasin J. S. kishte mospërputhje te disa të dhëna personale të regjistruara në sistem, me ato të certifikatës së kurorëzimit nga Republika e Shqipërisë. Identiteti i saktë i

shtetasit është kërkuar përmes rrugëve zyrtare nga ku ka rezultuar se personi i dyshuar ka të njëjtat të dhëna si personi i regjistruar në Kosovë, përveç datëlindjes. Lidhur me rastin është intervistuar i dyshuari D. N. në prani të avokatit dhe pas intervistës ndaj të njëjtit nga prokurori i Shtetit është lëshuar aktvendim për ndalim dhe i njëjti është dërguar në mbajtje për 48 orë. Ndërsa i dyshuari J. S., shtetas i Shqipërisë, do të intervistohet sapo të sigurohet prania e tij", thuhet në njoftim.



# Mitrovica e Veriut dhe Leposaviqi kërkojnë të paguajnë për rrymën e shpenzuar

PRISHTINË, 29 MAJ - Kryetari i Mitrovicës, Erden Atiq, dhe ai i Leposaviqit, Lulzim Hetemi, kanë kërkuar nga institucionet e Kosovës, që ndërtesat publike të këtyre komunave të kyçen në sistemin energjetik të Kosovës dhe të paguajnë për energjinë elektrike të komunave që udhëheqin. Këtë kërkesë ata ia kanë drejtuar Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Tregut (KOSTT) dhe Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE). “Gjithashtu, kërkoja që të na njoftojnë mbi borxhin që duhet të paguajnë institucionet e Republikës së Kosovës për rrymën e papaguar nga komuna që drejtojnë”, ka shkruar Atiq në “Facebook”.

Edhe Hetemi tha se pret të njoftohet për faturën e papaguar të komunës që drejton.

Mitrovica e Veriut, së bashku me tri komunat e tjera në veri të Kosovës të banuara me shumicë serbe, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, që nga përfundimi i luftës më 1999 nuk kanë paguar për rrymën e shpenzuar.

Kryetari i Mitrovicës, Erden Atiq, dhe ai i Leposaviqit,



Lulzim Hetemi, kanë kërkuar nga institucionet e Kosovës, që ndërtesat publike të këtyre komunave të kyçen në sistemin energjetik të Kosovës dhe të paguajnë për energjinë elektrike të komunave që udhëheqin.

Këtë kërkesë ata ia kanë drejtuar Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Tregut (KOSTT) dhe Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE). “Gjithashtu kërkoja që të na njoftojnë mbi borxhin që duhet ta paguajnë institucionet

e Republikës së Kosovës për rrymën e papaguar nga komuna që drejtojnë”, ka shkruar Atiq në “Facebook”.

Edhe Hetemi tha se pret të njoftohet për faturën e papaguar të komunës që drejton.

Mitrovica e Veriut, së bashku me tri komunat e tjera në veri të Kosovës të banuara me shumicë serbe, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, që nga përfundimi i luftës më 1999 nuk kanë paguar për rrymën e shpenzuar.

## A janë fitimet e korporatave ato që nxitin inflacionin global?



UASHINGTON, 29 MAJ - Derisa çmimet e ushqimeve dhe mallrave mbeten të larta në shumë vende, disa ekonomistë thonë se inflacioni i vazhdueshëm është pjesërisht për shkak të korporatave që kërkojnë rritjen e fitimit. Korrespondentja e “Zërit të Amerikës”, Veronica Balderas Iglesias, sjell mendimet e disa ekspertëve për faktorët e ndryshëm që kanë ndikuar në rritjen e inflacionit.

Në Fondin Monetar Ndërkombëtar në Uashington, studiuesi Daniel Leigh thotë se ka një farë optimizmi për një ulje modeste të nivelit të inflacionit global këtë vit. “Por kjo do të jetë një luftë e gjatë. Nuk mendojmë se shumica e vendeve do ta arrijnë nivelin e ulur të dëshiruar të inflacionit deri në vitin 2025”, thotë Leigh. Faktorë të ndryshëm kanë kontribuar që ekonomitë e zhvilluara dhe ato në zhvillim

ta kenë inflacionin më të lartë nga objektivat e tyre. “Një faktor ishte rritja e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve pjesërisht nga lufta në Ukrainë. Dhe përveç kësaj, shumë vende po përballen me mungesa në tregun e punës. Mungesa e punëtorëve të mjaftueshëm po rrit pagat”.

Në ekonomitë kapitaliste rritja e kërkesës sjell rritjen e çmimeve, por disa analistë shohin një formë të pazakontë

inflacioni, edhe pse, sipas vlerësimit të tyre, kërkesa mbetet e qëndrueshme. “Në përgjithësi, kompanitë që janë mjaft të afërta me konsumatorët kanë qenë në gjendje t’i bindin ata që të pranojnë jo vetëm rritjen e koston, por edhe pak më shumë se atë. Dhe kjo është sigurisht rritja e kufirit të fitimit”, thotë Paul Donovan, ekonomist me kompaninë ‘UBS Global Wealth Management’.

Kjo mund të mos jetë një qasje e qëndrueshme, vë në dukje Donovan. “Nëse konsumatorët fillojnë të thonë në fakt, ‘kjo nuk është një rritje e drejtë e çmimit, nuk do të paguaj për këtë’, atëherë kompanitë do të fillojnë të shqetësohen se nëse i rritin kufijtë e fitimit shumë, vlera e emrit së tyre do të dëmtohet”.

Federata Kombëtare e Shitjeve me Pakicë përfaqëson një spektër të gjerë kompanish. Hulumtuesi kryesor i saj pohon se kërkesa e konsumatorëve është rritur në mënyrë dramatike dhe i vlerëson argumentet e “inflacionit të udhëhequr nga fitimi” si “të drejtpërdrejta”. “Çdo ditë

shumë nga kompanitë tona mendojnë për uljen e çmimeve. Kur çmimet e mallrave rriten kudo dhe inventarët janë të ulët, shitësit me pakicë i kalojnë disa nga këto kosto te konsumatorët”. Atë që disa mund ta shohin si rritje të çmimeve, të tjerë e shohin si kufirin e çmimit që përballon tregun. Disa mund t’i kritikojnë “fitimet e tepërta”, ndërsa të tjerë vërejnë se rritja e fitimit është normë në një sistem të tregut të lirë.

Ekonomistët thonë se fitimi mund të rritet edhe nëpërmjet praktikave të mira të menaxhimit. “Nëse ke klientë më të mirë ose nëse ke një kapital njerëzor më të mirë brenda kompanisë, padyshim që do të kesh potencial ose do të kesh norma më të mëdha fitimi”, thotë Jonathan Fortun nga Instituti i Financave Ndërkombëtare.

Ulja e kërkesës së konsumatorit mund t’i detyrojë kompanitë të heqin dorë nga rritja e çmimeve dhe ta frenojnë inflacionin - synimi kryesor i bankës qendrore amerikane, e cila kohët e fundit rriti normat e interesit për të dhjetën herë në pak më shumë se një vit.



# Sindroma e Abdikimit: Pse disa njerëz ndjekin verbërisht liderët politikë apo fetarë?



Nga **Steve TAYLOR**  
"Psychology Today"

Disa vite më parë shkrova një artikull me titull "Sindroma e Abdikimit", në të cilin u përpoqa të shpjegoja fuqinë e disa udhëheqësve të kulteve fetare, guru-ve të korruptuar dhe udhëheqësve politikë mbi ndjekësit e tyre.

Këta të fundit heqin dorë nga përgjegjësia për jetën e tyre, nga vullneti i tyre, dhe ofrojnë njëpërkushtim të pakushtëzuar ndaj udhëheqësve. Ata u binden urdhrave të tyre, pa e vuar mendjen mbi pasojat, sikur të jenë gati të hipnotizuar.

Pavarësisht se sa keq sillen liderët, ndjekësit e tyre gjithmonë gjejnë një justifikim, për të ruajtur imazhin e pagabueshmërisë që kanë ndaj tyre. Unë argumentoj se kjo "Sindromë e Abdikimit" buron nga dëshira e pavetëdijshme e disa njerëzve për t'u rikthyer në gjendjen e fëmijërisë së hershme, kur prindërit e tyre ishin figura të pagabueshme, të plotfuqishëm, që e kontrollonin jetën e tyre dhe i mbronin nga bota.

Ata po përpiqen që ta ringjallin atë gjendje fëmijërie të përkushtimit dhe papërgjegjshmërisë së pakushtëzuar. Për ta nuk ka

nevojë që të mendojnë vetë, sepse udhëheqësi i tyre i di të gjitha përgjigjet. Nuk ka nevojë që të shqetësohen për asgjë, sepse mësuesi do të sigurojë gjithçka që u nevojitet.

Ata nuk ndihen më të pasigurt, të paplotë apo të hutuar. Ata thjesht shijojnë dashurinë dhe mbrojtjen e mësuesit, siç bënin dikur me prindërit e tyre. Në librin tim të ri "DisConnected", e përshkruaj me detaje të reja "Sindromën e Abdikimit". Ndër të tjera shpjegoj se sindroma është aq shumë e fuqishme, sa që çon në një gjendje specifike të ndryshuar të ndërgjegjes, ose siç mund ta quajmë ne, në një gjendje të abdikuar të vetëdijes.

Një herë bisedova me një mësues shpirtëror (guru) të njohur. Meqë mbërrita më herët sesa orari i takimit, u enda nëpër selinë e tij duke parë librat dhe objektet e tjera të qendrës. Bisedova edhe me një nga ndjekësit e mësuesit, i cili më shqetësoi paksa me shikimin e tij të zbrazët dhe admirimin fëmijëror që kishte ndaj mësuesit të tij.

"Ai është njësh! Është gjithçka që kam kërkuar. Që kur e ndjek atë gjithçka ka shkuar shumë mirë në jetën time"- më tha plot entuziazëm. M'u kujtua se e kisha ndeshur edhe më herët atëlloj

shikimi të zbrazët. Disa vite më parë, një e njohura ime më ftoi mua dhe të dashurën time të merrim pjesë në një seminar të grupit të saj shpirtëror.

E kuptova menjëherë se ajo gjë nuk ishte për mua. U zhgënjeva nga nderimi i madh që ata treguan për mësuesin e tyre (që në fakt nuk ishte i pranishëm). Sa herë që përmendnin emrin e tij, një buzëqeshje e madhe shfaqej në fytyrat e tyre, tamam si adoleshentët të dashuruar.

Po ashtu, unë u habita jo pak nga cilësia e dobët e mësimeve, të cilat ishin kryesisht jo koherente dhe plot klishe. Por ajo që më shqetësoi më shumë, ishte shikimi i zbrazët i secilit prej tyre. Çdokush, miqtë apo të afërmit e atij që i është bashkuar një kultit, do ta njohë këtë shikim të ngjashëm me ekstazën.

Siç vuri në dukje një ish-pjesëtar i Kishës së Unifikimit për anëtarët e grupit: "Ata të gjithë kishin sy të qelqtë, si dy vezë, që hapeshin aq shumë sa që dukej sikur bebëzat do u pëlcisnin". Në fakt, ky shikim "me sy të qelqtë" është investiguar nga studiuesit.

Sociologu Benjamin Zablocki e përshkroi këtë "vështrim të zymtë, të tërhequr" – së bashku me një buzëqeshje të frikshme të ngrirë – si një shenjë klasike të shpëlarjes

së trurit apo "nënshtrimit konjitiv ekstrem". Sociologu tjetër Mark Galanter, besonte se "vështrimi i qelqtë" ka një efekt izolues. Ai përcakton kufijtë e grupit dhe i largon të huajt.

Por nga këndvështrimi im, shikimi me "sy të qelqtë" është një shenjë e sigurt e "Sindromës së Abdikimit". Ai është vështrimi i njerëzve që kanë hequr dorë nga përgjegjësia për jetën e tyre dhe janë kthyer në gjendjen e përkushtimit si fëmijë ndaj një figure atërore.

Kjo gjendje e abdikuar e ndërgjegjes është e ngjashme me hipnozën. Tek e fundit, tipari thelbësor i hipnozës, është se një person heq dorë nga vullneti i tij dhe e lejon hipnotizuesin të marrë përsipër "funksionet ekzekutive" të mendjes, të cilat menaxhojnë sjelljen tonë dhe kontrollojnë vendimet dhe emocionet tona.


Unë jam pak ngurrues për të përdorur termin "shpëlarje truri" në këtë kontekst, pasi kjo nënkupton se anëtarët e kultit janë viktimë të pafajshme të liderëve keqdashës. Në librin tim të ri, unë sugjeroj që udhëheqësit e kultit, gurutë e korruptuar dhe udhëheqësit politikë autoritarë janë personalitete "që nxitin një shkëputje të madhe nga bota" dhe që dëshirojnë pushtet dhe

admirim.

Ashtu si me hipnozën – kur një subjekt e lejon hipnotizuesin të marrë përsipër vullnetin e tij Sindroma e Abdikimit është (të paktën në fillim) një marrëveshje midis ndjekësit dhe udhëheqësit. Ndjekësi ka një nevojë psikologjike për të adhuruar dikë, ndërsa udhëheqësi ka nevojë psikologjike për t'u adhuruar.

Është një marrëveshje midis një personi që dëshiron të marrë rolin e fëmijës dhe një personi që dëshiron të marrë rolin e prindit. Sindroma e Abdikimit nuk sjell një përfundim të mirë. Ashtu si të gjitha marrëdhëniet toksike, marrëdhënia midis liderëve autoritarë dhe ndjekësve të tyre të nënshtruar, është e dënur të shkojë keq që në fillim.

Sepse ajo bazohet në patologji nga të dyja anët: hiper-ndikim e liderëve, dhe pasiguria dhe papjekuri psikologjike e ndjekësve të tyre. Po ashtu, është një marrëdhënie shumë e paqëndrueshme, për shkak të hendekut gjigant midis liderit (me bashkëpunëtorët e tij) dhe ndjekësve të tij të nënshtruar. Çdo patokraci – në formën e një kultit ose një qeverisje – çon në mënyrë të pashmangshme drejt konfliktit, kaosit dhe vetë-shkatërrimit.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Kosova, me tetë skuadra në Kupa Evropiane

PRISHTINË, 29 MAJ - Federata e Hendbollit e Kosovës e ka të drejtën e paraqitjes me tetë skuadra në Kupat Evropiane në edicionin garues 2023/2024. Te hendbollistët katër skuadra mund të paraqiten për të garuar në Kupën Evropiane (EHF European Cup), ndërsa

te hendbollistët, kampioni, Istogu, e ka të drejtën e paraqitjes në Ligën Evropiane (EHF European League). Tri skuadra të tjera mund të paraqiten në Kupën Evropiane (EHF European Cup). Besa Famgas, Istogu, por edhe skuadrat e tjera do të synojnë të

bëjnë hap para në Kupa Evropiane në edicionin e ardhshëm garues. "Shumica e skuadrave të Kosovës pritet ta shfrytëzojnë të drejtën e garimit në gara evropiane në edicionin tjetër që fillon në vjeshtë", thuhet në njoftimin e FHK-së.



# Dy ndeshjet e dyshuara për kurdisje janë proceduar për hetime në prokuroritë përkatëse

Zëvendësministrja e Sportit dhe Këshilli për Sport kanë njoftuar se dy ndeshjet e dyshuara për kurdisje Prishtina - Trepça '89 dhe Ferizaj - Dukagjini janë proceduar për hetim në prokuroritë përkatëse. Rreth këtij rasti ka reaguar edhe Federata e Futbollit, e cila është zotuar se çdo pretendim që vërtetohet do të ndëshkohet me ashpërsi në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret përkatëse

**EPOKA ERE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 MAJ - Kampionati 2022/23 në Superligën e Kosovës në futboll është mbyllur me dyshimin për kurdisje në dy ndeshjet përcaktuese për skuadrën që do të binte nga elita dhe për atë që do të përfundonte në barazh. Fjala është për ndeshjet Prishtina - Trepça '89 dhe Ferizaj - Dukagjini. Lidhur me këto dyshime ka reaguar zëvendësministrja për Kulturë, Rini dhe Sport (MKRS), Daulina Osmani. E dyta e MKRS-së ka kërkuar nga organet kompetente t'i hetojnë ndeshjet në fjalë, duke insistuar se "nuk mund t'i mbyllim sytë para dyshimeve". "Ndeshjet e futbollit që u zhvilluan dje në kuadër të Superligës së Kosovës, Prishtina me Trepçën '89 dhe Ferizaj me Dukagjinin, që të dyja janë proceduar për hetime në prokuroritë përkatëse nga Këshilli për Parandalimin e

Dhunës në Sport. Nuk mund t'i mbyllim sytë para dyshimeve, por as edhe të jemi pre e spekulimeve. Andaj, kërkojmë nga autoritetet dhe personat përgjegjës të organeve të rendit që të procedojnë tutje me shumë kujdes dhe me kohë. Është e dhimbshme kur imazhi i sportit në vend njolloset me shenja që shkaktojnë dëme të thella dhe vështirë të riparueshme në komunitet", ka thënë Osmani, duke shtuar se sporti duhet të jetë vetëm i sportistëve, derisa kalkulimet e ndryshme nuk duhet të kenë vend në sport. "Sporti është i sportistëve dhe atyre që punojnë për rezultate. Kalkulimet dhe llogaritë e përfitimeve mbi djersën dhe mundin e tyre nuk duhet të kenë vend në sportin vendor në asnjë formë dhe asnjë moment", ka shtuar ajo.

Lidhur me dyshimet për kurdisje ka reaguar edhe Këshilli Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe



Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive. Këshilli në fjalë ka njoftuar se dyshimet për kurdisjet eventuale janë adresuar menjëherë te prokuroritë kompetente për verifikimet dhe hetimet e nevojshme. "Këshilli Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive (Këshilli për Sport) me vëmendje të shtuar e ka përcjellë zhvillimin e ndeshjeve të xhiros së fundit të Kampionatit të Kosovës në Futboll, duke përfshirë edhe reagimet e shumta të opinionit sportiv në relacion me dyshimet për kurdisjen eventuale të rezultatit të dy ndeshjeve të Superligës së futbollit të zhvilluara ndërmjet KF Ferizaj - KF Dukagjini dhe KF

Trepça '89 - KF Prishtina. Këshilli për Sport e njofton opinionin publik se çështjet në fjalë i ka trajtuar me urgjencë dhe dyshimet për kurdisje të rezultatit në dy ndeshjet e sipërshtënuara të futbollit janë adresuar menjëherë te prokuroritë kompetente për verifikimet dhe hetimet e nevojshme. Opinioni publik do të njoftohet me kohë lidhur me rrjedhën e procesit të hetimeve", thuhet në komunikatën e lëshuar nga Këshilli për Sport, i cili drejtohet nga kryetari Besim Kelmendi.

Pas reagimeve të shumta lidhur me dyshimet për kurdisje në dy ndeshje të Superligës, ka reaguar edhe Federata e Futbollit e Kosovës. FFK-ja ka njoftuar se i ka marrë të gjitha informacionet

relevante për dy ndeshjet më të përfolura të kësaj xhiroje, Ferizaj - Dukagjini dhe Trepça'89 - Prishtina. "Federata, në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar për Parandalimin e Dhunës në Sport, e nëpërmjet tij edhe me Prokurorinë e Shtetit, do të angazhohet maksimalisht për hetimin e të gjitha pretendimeve për kurdisje të ndeshjeve dhe prishje të 'fair-play'. Çdo pretendim që vërtetohet do të ndëshkohet me ashpërsi në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret përkatëse. FFK do të vazhdojë të angazhohet me përkushtim maksimal për ta mbrojtur integritetin e garave dhe imazhin e futbollit të Kosovës në përgjithësi", thuhet në reagimin e FFK-së.

## Llapi ndërpret bashkëpunimin me Fernandinhon

PODUJEVË, 29 MAJ - Klubi i Futbollit të Llapit ka njoftuar një ditë pas përfundimit të kampionatit, se me marrëveshje të dyanshme është ndërprerë kontrata me futbollistin Fernandinho. "KF Llapi njofton opinionin se me marrëveshje të dyanshme ka

vendosur të ndërpresë bashkëpunimin me mbrojtësin e majtë, Fernando Augusto - Fernandinho. Fernandinho u paraqiti për klubin tonë në gjithsejtë 34 paraqitje duke kontribuar me dy gola dhe tri asistime. Fernandinhos i dëshirojmë

shumë suksese në vazhdim të karrierës si dhe e falënderojmë për kontributin e dhënë për klubin tonë gjatë këtij edicioni", thuhet në njoftimin e skuadrës llapjane. Skuadra e Llapit edicionin 2022/2023 e mbylli në pozitën e shtatë me 43 pikë të grumbulluara.



## Arteta: Xhaka ishte i jashtëzakonshëm

LONDËR, 29 MAJ - Granit Xhaka ka shënuar dy gola në ndeshjen që Arsenali e fitoi ndaj Wolverhamptonit (5-0), kurse kjo ndeshje mund të jetë edhe e fundit për mesfushorin shqiptar në fanellën e "Gunnerns". Trajneri Mikel

Arteta e ka lavdëruar Xhakën për lojën e fundit, por edhe për tërë sezonin. "Mjaft e merituar, ai e kishte një sezon të jashtëzakonshëm. Një vit më parë i thashë që ka një pikëpyetje për ty, që duhet të japësh më shumë, që duhet të

jesh më i mirë. Ai u rikthye dhe stërviti të nesërmen, ndërsa në fazën përgatitore u rikthye me katër kilogramë më pak, fit dhe në fytyrën e tij mund ta shihje vendosmërinë për ta bërë atë. Ai ishte i jashtëzakonshëm, pjesë e rëndësishme e suksesit

të ekipit dhe jam mjaft i lumtur që të gjithë po e vlerësojnë atë që e ka bërë ai", ka thënë Arteta. Granit Xhaka pritet të largohet nga Arsenali dhe të transferohet në afatin kalimtar të verës në Bayer Leverkusën.



## Flamur Gashi, "Ylli i javës" në Superligë

PRISHTINË, 29 MAJ - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, kanë dhënë çmimin "Ylli i javës" për Javën e 36-të (të fundit) në Albi Mall Superligë. Ky çmim i ka takuar portierit të KF Malisheva, Flamur Gashi. Komisioni i veteranëve të futbollit vendosi që epiteti i më të mirit për këtë xhiro t'i takojë portierit të skuadrës malishevase, pasi në ndeshjen kundër Llapit ai e priti penalltinë në minutën e fundit, duke ia mundësuar FC Malisheva t'i gëzohet fitores. Çmimin "Ylli i javës" për futbollistin e KF Malisheva, Flamur Gashi, e dha Edon Sejday, dizajner grafik në Albi Mall. Pasi mori këtë çmim, Gashi u shpreh i lumtur që skuadra e tij e përmbushi me sukses misionin e saj për mbetje në elitë. "Ndihehem shumë mirë dhe i lumtur për këtë vlerësim dhe dua t'i falënderoj



bashkëlojtarët e skuadrës dhe shtabin teknik pa të cilët sigurisht se nuk do të mund ta fitoja këtë çmim. Shpresoj se ky çmim, i cili është i pari për mua, nuk do të jetë i fundit, ndonëse të shpërblehesh në fund të kampionatit është qershia mbi

tortë. Me lojën e djeshme e kemi mbyllur kampionatin me sukses si ekip, por edhe në aspektin individual. Kemi merituar më shumë, por ky është futbollit dhe duhet të jemi të lumtur me atë që kemi arritur", ka thënë Gashi për faqen zyrtare të FFK-së.

## Zyrtare: Pochettino, trajner i Chelseat

LONDËR, 29 MAJ - Skuadra e Chelseat ka konfirmuar se Mauricio Pochettino do të bëhet trajner i skuadrës së tyre nga fillimi i sezonit 2023/24. Argjentinasi do të fillojë rolin e tij të ri më 1 korrik 2023 me një kontratë dyvjeçare, me një opsion klubi për një vit tjetër. "Ekipi sportiv kreu një proces të zellshëm dhe të menduar për të cilin bordi është krenar. Jemi të kënaqur që Mauricio do t'i bashkohet Chelseat. Mauricio është një trajner i klasës botërore, me një histori të jashtëzakonshme. Të gjithë mezi presim ta kemi atë në bord", ka thënë presidenti Boehly. Pochettino është trajner i njohur për energjinë e lartë dhe stilin tërheqës të skuadrave të tij dhe ai ka krijuar një reputacion për t'i ndihmuar lojtarët e rinj ta realizojnë potencialin e tyre të plotë brenda një etike të fortë skuadre. 51-vjeçari ka disa sezone përvojë në Premierë Ligë, përveç trajnerit në Spanjë dhe Francë. Ai ishte së fundmi në krye të Paris Saint-Germain dhe e udhëhoqi klubin drejt titullit të Ligës 1 dhe Coupe de France.



## De Laurentiis: E falënderoj Spallettin për punën e bërë, cikli mbyllet këtu

Presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis, ka zyrtarizuar ditën e djeshme lamtumirën e trajnerit Luciano Spalletti. "Ai është një njeri i lirë tashmë. Kur dikush të vjen dhe të thotë se në thelb ka bërë më të mirën dhe një cikël i jetës ka përfunduar, çfarë duhet

bërë? A e kundërshton dot? Ai më tha se do të kishte më mirë një vit pushim, më mirë të ndalonte pak. Unë e falënderoj dhe i uroj më të mirën. Spalletti është një person i jashtëzakonshëm dhe një trajner i madh. Tani është e drejtë që ai të vazhdojë atë që do,

unë do ta respektoj zgjedhjen e tij pavarësisht kontratës", është shprehur numri një i kampionëve të Italisë. Presidenti i Napolit, gjithashtu, ka prekur pak edhe çështjen e "Scudetos". "Në fillim të sezonit ne kishim larguar lojtarët më të

rëndësishëm që kemi pasur në ekip ndër vite. Afruam lojtarë të tjerë që shumë pak kishin dëgjuar për ta. Na pyetën në konferencë për shtyp se çfarë objektivi keni, dhe unë u përgjigja duke thënë se do ta fitojmë kampionatin. Të gjithë më panë

çuditshëm, edhe Spalletti gjithashtu. Ne krijuam një bazë me disa lojtarë të talentuar, ndërsa Spalletti me punën e tij fantastike arriti të nxirrte më të mirën prej tyre, dhe sot ne jemi kampionët e Italisë", ka përfunduar De Laurentiis.

### SHKURT

#### Drita 'blindon' Brojën

Skuadra nënkampione Drita nga Gjilani ka njoftuar se ka vazhduar bashkëpunimin me mesfushorin Rron Broja edhe për dy vjet. "Është kënaqësi të vazhdoj me njërin prej klubeve më profesionale dhe më të organizuara. Ndiej përgjegjësi dhe obligim që klubit dhe tifozëve tanë t'ua kthejmë krenarinë me suksese vitin që vjen. Faleminderit të gjithëve për besimin dhe për mua nuk ka qenë aspak e vështirë që t'i them po klubit për të vazhduar", ka thënë Broja. Drita deri në javën e parafundit ishte në garë për titull të kampiones, kur e humbi ndeshjen nga Malisheva (0-1).

#### Bellinghami, 'Lojtari i vitit' në Bundesliga

Jude Bellingham e mori çmimin "Lojtari i vitit" në Bundesliga. Borussia Dortmundi humbi një epërsi prej dy pikësh dhe ia dhuroi titullin e ligës Bayern Munchenit pasi arriti vetëm një barazim 2-2 kundër Mainzit në ndeshjen e fundit. Pavarësisht prej gjithë zhgënjimit për humbjen e titullit në ditën e fundit, Bellinghami arriti të merrte një çmim ngushëllues duke fituar çmimin "Lojtari i Vitit". Reprezentuesi anglez shijoi një sezon të shkëlqyer me skuadrën gjermane pasi shënoi 14 gola dhe dha shtatë asistime në 42 ndeshje.

#### Pioli: Për të fituar duhen përforcime

AC Milan shpëtoi një xhiro përpara fundit. Lojtarët e Stefano Piolit siguruan matematikisht një biletë për në Ligën e Kampionëve. Milani e kthen në festë transfertën përballë Joves, thyen 0-1 "Zonjën e Vjetër", duke blinduar vendin e katërt në Serinë A. Trajneri Stefano Pioli bën bilancet e sezonit: "Liga e Kampionëve na ka dhënë më shumë se pritej këtë sezon, por më pas na la një shije të lidhur pasi dolëm jashtë nga Interi. Në kampionat mund të bënim diçka më shumë, por ky ishte viti i parë që konkurronim në dy fronte. Të mos harrojmë që duhet të bënim pa Maignan për pesë muaj. Gjithsesi, të shijojmë këtë arritje dhe të mendojmë për sezonin e ri. Baza është solide, por për të fituar duhen përforcime".

#### Ten Hag: Rashfordi sezonin tjetër duhet të shënojë 40 gola

Një prej lojtarëve kryesor në këtë edicion për Manchester Unitedin është Marcus Rashford. Trajneri Erik ten Hag ka thënë se sulmuesi anglez duhet të shënojë 40 gola në edicionin e ardhshëm. "Mendoj se Rashford mund të përmirësohet edhe më tepër. Jam i bindur se mund të shënojë më shumë se 30 gola sepse ju kujtoj se në dhjetë ndeshjet e fundit nuk ka shënuar shumë dhe shifrat mund të ishin edhe më të mira. Skuadra e ka mbështetur shumë dhe jemi të lumtur, por sezonin tjetër pres që ai të shënojë 40 gola. Ky është hapi i radhës për Rashford", ka thënë Ten Hag.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




**MEKA**  
HALAL FOOD  
**PASHTETË PULË**

gluten  
free



100% mish pulë



*cilësi e garantuar*

pa konservues